

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 316, Datë 12.12.2025

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 168, DATË 26.08.2024
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUN’S MIRACLE” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2856/2 prot., datë 25.11.2025, “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 168, datë 26.08.2024 “Mbi licencimin e shoqërisë “SUN’S MIRACLE” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “SUN’S MIRACLE” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 168, datë 26.08.2024, ka licencuar shoqërinë “SUN’S MIRACLE” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 30-vjeçar.
- Në pikën 2 të vendimit nr. 168/2024 është përcaktuar se shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, jo më vonë se data 15.09.2024.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i administruar

- Nga raportimet periodike të shoqërisë “SUN’S MIRACLE” sh.p.k. dhe nga publikimet periodike të ERE-s mbi të dhënat e tregut të energjisë elektrike rezulton se shoqëria ka filluar të ushtrojë aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike prej muajit nëntor 2024, ku për vitin 2024 ka prodhuar gjithsej 344 MWh, ndërsa për periudhën janar–shtator 2025, sasinë prej 3439 MWh.
- ERE, me shkresën nr. 2856 prot., datë 13.11.2025, i ka kërkuar shoqërisë depozitimin në ERE të një kopjeje të testimit të veprës, në mbështetje të pikës 2 të vendimit nr. 168/2024.
- Shoqëria “SUN’S MIRACLE” sh.p.k., me shkresën nr. Ekstra prot., datë 18.11.2025, protokolluar në ERE me nr. 2856/1 prot., datë 18.11.2025, ka paraqitur, ndër të tjera, këto të dhëna:
 - Me shkresën e saj nr. Ekstra prot., datë 12.09.2024 “Njoftim mbi përfundimin e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltai SUN’S MIRACLE 2 MW”, i ka njoftuar MIE-në dhe AKBN-në për përfundimin e punimeve, duke iu referuar procesverbalit të përfundimit të punimeve të datës 12.09.2024 dhe duke kërkuar kryerjen e testimit të veprës në zbatim të nenit 10 të Kontratës nr. 1569 Rep., nr. 1036 Kol., datë 21.03.2023.
 - Shoqëria bën me dije se, për shkak se testimi nuk është kryer nga MIE dhe AKBN brenda afatit 45-ditor të parashikuar në kontratë dhe për shkak se grupi i AKBN-së

është paraqitur në objekt përpara datës së energjizimit të centralit (07.11.2024, sipas shkresës së OSSH sh.a. nr. 10549/6 prot., datë 29.10.2024), testimi i veprës është realizuar më datë 09.11.2024 nga vetë Mbajtësi i Miratimit për Ndërtim (SUN'S MIRACLE sh.p.k.), sipërmarrësi i punimeve dhe mbikëqyrësi i punimeve.

- Dokumenti “Testimi i Parkut Fotovoltaik SUN'S MIRACLE 2 MW” i është vënë në dispozicion AKBN-së dhe MIE-së për dijeni dhe për vijimin e procedurave për Raportin e Vlerësimit të Investimit dhe Certifikatën e Pranimi të Veprës, në zbatim të VKM nr. 506, datë 01.08.2024 dhe Kontratës nr. 1569 Rep., nr. 1036 Kol., datë 21.03.2023.
 - Me shkresën nr. 176/5 prot., datë 23.06.2025, AKBN ka njoftuar shoqërinë për përfundimin e Raportit të Vlerësimit të Investimit dhe Certifikatës së Pranimi të Veprës të parkut fotovoltaik “SUN'S MIRACLE” 2 MW, duke kërkuar paraprakisht pagesën e tarifës prej 1% të vlerës së investimit, në përputhje me kuadrin ligjor.
 - Shoqëria ka vijuar raportimin periodik pranë ERE-s, në zbatim të seksionit 3.2 “Llogaritë dhe Raportimi”, pika 3.2.2 të licencës nr. 587, Seria P24, sipas vendimit nr. 168, datë 26.08.2024.
- Gjithashtu shoqëria bashkëlidhur shkresës së datës 18.11.2025, shoqëria ka depozituar edhe: Vërtetimin e njësisë me origjinalin të procesverbalit të përfundimit të punimeve të datës 12.09.2024; Vërtetimin e njësisë me origjinalin të shkresës së datës 12.09.2024 drejtuar MIE dhe AKBN; Një kopje origjinale të dokumentit “Testimi i Parkut Fotovoltaik SUN'S MIRACLE 2 MW”; Vërtetimin e njësisë me origjinalin të shkresës së AKBN nr. 176/5 prot., datë 23.06.2025.

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Nga procesverbali i përfundimit të punimeve dhe njoftimi i datës 12.09.2024 rezulton se punimet për ndërtimin e centralit fotovoltaik kanë përfunduar përpara afatit të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 168, datë 26.08.2024.
- Testimi i veprës është kryer më datë 09.11.2024 dhe, në vijim, AKBN ka hartuar Raportin e Vlerësimit të Investimit dhe Certifikatën e Pranimi të Veprës, duke kushtëzuar pajisjen e shoqërisë me këto dokumente vetëm me kryerjen e pagesës së tarifës ligjore.
- Leja e ndërtimit e miratuar nga KKT, me afat vlefshmërie 12-muaj deri më 15.04.2025, është respektuar në praktikë, pasi vënia në punë e centralit dhe fillimi i prodhimit të energjisë elektrike janë kryer brenda këtij afati.
- Edhe pse afati i përcaktuar në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s (15.09.2024) nuk është respektuar në mënyrë strikte (meqenëse parku ka hyrë në operim në nëntor 2024), ky afat ka qenë i përafërt dhe i vetëdeklaruar nga shoqëria në fazën e aplikimit, ndërsa, në aspektin material, shoqëria ka përmbushur detyrimin për vënien në operim të impiantit brenda afateve të lejes së ndërtimit dhe kontratës me MIE.
- Në këto kushte, pika 2 e vendimit nr. 168/2024 ka përfunduar efektin e saj dhe nuk ka më funksion kushtëzues të pavarur për vijimin e veprimtarisë së licencuar.

4. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se:
- Pika 2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 168, datë 26.08.2024, duhet të shfuqizohet, pasi kushti për vënien në operim të centralit fotovoltaik është përmbushur dhe afati i përcaktuar në këtë pikë nuk ka më funksion praktik.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit të ERE-s nr. 168, datë 26.08.2024, shfuqizohet.
2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “SUN’S MIRACLE” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI